



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/19
Datë: 15.06.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2011, mori

V E N D I M

1. Miratohen ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 17 e Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/19

Datë: 15.06.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2011, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/19

Datë: 15.06.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2011, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së tyre.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/19

Datë: 15.06.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2011, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/19
Datë: 15.06.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2011, mori

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja për Pushimet e Nëpunësve Civil.
2. Obligohet Ministria e Administratës Publike dhe të gjitha institucionet tjera për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/19
Datë: 15.06.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2011, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjetet financiare në vlerë prej 150,000.00 (njëqind pesëdhjetëmijë) euro për mbulimin e shpenzimeve për rehabilitimin e 750 (shtatëqindpesëdhjetë) Veteranëve të luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
2. Mjetet nga pika 1. të këtij vendimi ndahen nga buxheti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe transferohen në xhirollogarinë e Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-ës.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/19

Datë: 15.06.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2011, mori

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 02/2011, për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrive.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe të gjitha ministrinë për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/19
Datë: 15.06.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2011, mori

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Kombëtar për Sigurimin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, në këtë përbërje:

1.1. Ministri i Punëve të Brendshme,	kryesues;
1.2. Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil,	zv. kryesues;
1.3. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës,	anëtar;
1.4. Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës,	anëtar;
1.5. Ministri i Infrastrukturës,	anëtar;
1.6. Ministri i Financave,	anëtar;
1.7. Ministri i Punëve të Jashtme,	anëtar;
1.8. Drejtori i Agjencionit Kosovar të Inteligjencës,	anëtar;
1.9. Ministri i Shëndetësisë,	anëtar;
1.10. Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror,	anëtar.

2. Komisioni siguron se Republika e Kosovës:

- a. Plotëson obligimet ndërkombëtare të cilat rrjedhin nga Marrëveshja për themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit ("Marrëveshja ECAA");

- b. Plotëson obligimet ndërkombëtare të cilat rrjedhin nga Konventa mbi Aviacionin Civil ndërkombëtar të datës 7 dhjetor 1944 ("Konventa e Çikagos") dhe Konventave tjera ndërkombëtare në fushën e sigurimit të Aviacionit Civil;

- c. Përmbush detyrimet specifike në fushën e sigurimit të aviacionit civil të përcaktuara në dokumentet e Konferencës Evropiane të Aviacionit Civil ("ECAC");

- d. Siguron që të zbatohet legjislacioni dhe Programet Kombëtare të Sigurimit të Aviacionit Civil;
- e. Përcakton shkallën e kërcënimit të Aviacionit Civil nga aktet e ndërhyrjes së pa ligjshme;
- f. Siguron koordinimin, komunikimin dhe bashkëpunimin në mes të organeve kompetente të Republikës së Kosovës me qëllim të zbatimit efikas të masave, veprimeve dhe praktikave më të mira me qëllim parandalues dhe veprime efikase në raste emergjente.
3. Në raste specifike anëtari i Komisionit mund ti delegoj përkohësisht përgjegjësit e tij tek zëvendësi i tij i parë.
4. Punët profesionale për Komisionin kryhen nga Sekretariati i Komisionit.
5. Kryesuesi i Komisionit emëron anëtarët e Sekretariatit.
6. Organizimi dhe mënyra e punës së Komisionit përcaktohet me rregulloren e punës të cilën e miraton Komisioni.
7. Rregullorja e punës miratohet nga Komisioni brenda 45 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
8. Për mbledhjet e rregullta, Komisioni raporton tek Kryeministri dhe Presidenti i Republikës së Kosovës.
9. Veprimtaria e Komisionit, nuk kufizon organet kompetente nga përgjegjësit e përcaktuara sipas ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
10. Mjetet për punën e Komisionit dhe Sekretariatit ndahen nga Buxheti i Ministrisë së Punëve të Brendshme.
11. Komisioni themelon në çdo aeroport të Republikës së Kosovës komisionet lokale të sigurimit të aeroporteve.
12. Për anëtar të komisioneve lokale të sigurimit të aeroporteve emërohen personat të cilët kanë mandat të drejtpërdrejtë në zbatimin e masave të sigurimit të aviacionit civil në aeroport.
13. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/19
Datë: 15.06.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2011, mori

V E N D I M

1. Të Shpallet zonë nën mbrojtje dhe me interes të veçantë hapësira ku është zhvilluar "Beteja e Koshares" nga Brigada 138 Agim Ramadani me sipërfaqe prej 2488 ha në Komunën e Gjakovës sipas tabelës me ngastra kadastrale të bashkangjitura në aneks të këtij vendimi.
2. Shpronësimi i ngastrave kadastrale të paraqitura në tabelë aneks të këtij vendimi do të bëhet sipas Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme të Republikës së Kosovës.
3. Obligohen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/19
Datë: 15.06.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2011, mori

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E INSTITUTIT PËR HULUMTIMIN E KRIMEVE TË LUFTËS

Neni 1
Themelimi dhe Qëllimi

1. Themelohet Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë (më tej: Instituti) si institucion publik hulumtues me qëllim të mbledhjes, sistematizimit, përpunimit dhe publikimit të dhënave për krime kundër paqes, krime të luftës, krime kundër njerëzimit dhe akteve të gjenocidit të kryera në Kosovë gjatë vitit 1998 deri në qershor të vitit 1999.
2. Instituti do të veprojë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 2
Veprimtaria e Institutit

1. Instituti do të merret me punët hulumtuese dhe punët e tjera lidhur me:
 - 1.1 Hulumtimin e krimeve të luftës nga aspekti historik, ushtarak, juridik, sociologjik dhe aspektet e tjera me rëndësi për shqyrtimin e këtyre ngjarjeve;
 - 1.2 Analizën e krimeve të kryera dhe të ngjarjeve tjera relevante, përpunimin e tyre, verifikimin dhe zhvillimin e bazës së të dhënave për ngjarjet dhe pasojat e tyre dhe për lëndët penale të krimeve të luftës;
 - 1.3 Grumbullimin, përpunimin, klasifikimin dhe arkivimin e lëndëve arkivore për krimet e luftës, krimet e kryera kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të

drejtën ndërkombëtare dhe të ngjarjeve tjera në territorin e Republikës së Kosovës prej vitit 1998 e deri në vitin 1999;

- 1.4 Krijimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave dhe të shënimeve të krimeve të luftës në Kosovë dhe ua bënë të mundur institucioneve të interesuara shfrytëzimin e tyre;
- 1.5 Përgatitjen e të dhënave statistikore dhe të dhënave tjera mbi rezultatet e hulumtimeve;
- 1.6 Bashkëpunimin me organet e tjera të ngjashme, organet gjyqësore, organizatat qeveritare dhe jo qeveritare dhe individët;
- 1.7 Publikimin e rezultateve të hulumtimeve;
- 1.8 Konceptimin e hartimit të projekteve shkencore - hulumtuese, si bazë shkencore e organizimit dhe realizimit të hulumtimeve shkencore kundër krimeve të luftës;
- 1.9 Ofrimin e ndihmës shkencore dhe profesionale hulumtuese në hulumtimin e kësaj fushe;
- 1.10 Zhvillimin e bashkëpunimit përkatës me institucionet shkencore dhe profesionale në vend dhe jashtë vendit;
- 1.11 Publikimin e punimeve shkencore dhe profesionale;
- 1.12 Organizimin e konferencave shkencore, seminare dhe ligjërata në vend dhe jashtë vendit;
- 1.13 Sigurimin e mjeteve materiale për punën shkencore hulumtuese, për grumbullimin e të dhënave për krimet e luftës, veprimtarisë botuese, mjeteve materialo-teknike dhe të nevojave tjera për Institutin;
- 1.14 Koordinimin e aktiviteteve të të gjitha institucioneve dhe organizatave në Republikën e Kosovës të cilat merren me hulumtimin krimeve të luftës;
- 1.15 Kryerjen edhe të aktiviteteve tjera me rëndësi për arritjen e qëllimit të grumbullimit, sistemit dhe përpunimit të të dhënave që ndërlidhen me krimet e luftës;
- 1.16 Kryen punët e tjera profesionale që ia beson Ministri i Drejtësisë.

Neni 3 Udhëheqja me Institutin

1. Me Institutin udhëheq Këshilli i Institutit për Hulumtime të Krimeve të Luftës (më tej: Këshilli).
2. Këshillin, i cili përbëhet prej Kryetarit dhe 7 anëtarëve, me vendim të veçantë e emëron Ministri i Drejtësisë.

3. Këshilli, me pëlqimin e Ministrit të Drejtësisë, nxjerrë Statutin e Institutit dhe rregullat e punës së Këshillit.
4. Kryetari i Këshillit është përgjegjës për menaxhimin e gjithëmbarshtëm të Institutit dhe për sigurimin e zbatimit të autorizimeve që i janë bartë Institutit, si dhe menaxhimin efektiv dhe efikas të Këshillit.
5. Kompensimi i punës së kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit si bashkëpunëtor profesional të jashtëm do të bëhet nga kategoria ekonomike 13440 shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse.
6. Të drejtat lidhur me kompensimin për punën dhe shpenzimet e tjera të anëtarëve në Këshill do të përcaktohen me Vendimin të veçantë të cilin e nxjerrë Ministri i Drejtësisë.
7. Me qëllim të realizimit më efikas të veprimtarisë shkencore hulumtuese dhe të aktiviteteve tjera të cilat përcjellin këtë fushë, Këshilli mund të themelojë trupat e saja të punës të përhershme apo të përkohshme të cilat i ndihmojnë në punë.
8. Në trupat punuese të Këshillit, mund të emërohen profesionist të shquar në fushën për të cilën është themeluar trupa punuese. Numrin, përbërjen, emërimin, detyrat dhe mënyrën e punës së trupave të përhershme dhe të përkohshme të punës të Këshillit do të përcaktohen me vendimin për themelimin e tyre.
9. Ministria e Drejtësisë obligohet që të sigurojë kushtet e domosdoshme për punën e Institutit dhe të Këshillit, ndërsa nëpërmjet të një sekretariati me personel të nevojshëm siguron mbështetje administrative për Këshillin.

Neni 4 Hyrja në fuqi

1. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, dhe shfuqizon vendimin e Qeverisë, nr.05/13 të datës 29.04.2011.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/19
Datë: 15.06.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 42 të Ligjit nr.03/L-188 për Produkte dhe Pajisje Medicinale, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2011, mori

V E N D I M

1. Autorizohet Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale, që të lëshoj licencë importi për një sasi dhe lloj të caktuar të produkteve medicinale pa autorizim të marketingut për të cilat aktualisht nuk ekziston zëvendësimi me produkt medicinal esencialisht të ngjashme të Regjistruar në Republikën e Kosovës.
2. Për sasinë, llojin, cilësinë dhe afatin të këtyre produkteve medicinale Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale do të caktoj grupin punues profesional i cili do ti propozoj drejtorit të Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale ndërmarrjen e masave të veçanta.
3. Drejtori i Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale sipas propozimit të grupit punues dhe pas aprovimit të Ministrit të Shëndetësisë do të ndërmarr masa të veçanta.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, dhe shfuqizohet pas 30 ditëve

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/19

Datë: 15.06.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2011, mori

V E N D I M

1. Ministria e Financave të krijoj një linjë të re buxhetore në tabelat e buxhetit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011 për Ministrinë e Diasporës.
2. Për Ministrinë e Diasporës, ndahen mjete financiare në vlerë prej 750,000.00 (shtatëqindpesëdhjetë mijë) euro sipas këtyre kategorive:
 - 2.1. Mallra dhe Shërbime 270,000.00 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) euro;
 - 2.2. Paga 180,000.00 (njëqindetëdhjetë mijë) euro;
 - 2.3. Investime Kapitale 300,000.00 (treqind mijë) euro.
3. Mjetet financiare nga pika 2 e këtij vendimi ndahen nga shpenzimet e paparashikuara, kodi organizativ 232, dhe transferohen në Ministrinë e Diasporës.
4. Numri total i të punësuarve i lejuar për Ministrin e Diasporës është prej 35, nga të cilët prej Programit "Çështjet jo-rezidente" në Zyrën e Kryeministrit barten 12 nëpunës.
5. Ministria e Diasporës dërgon në Ministrin e Financave strukturën organizative sipas programeve, punësimit dhe kategorive ekonomike për mjetet e ndara sipas pikës 2 dhe 4.
6. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Diasporës, për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë